VENDIM
Nr. 154, datë 3.7.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "OBERALDI ENERGJITIK" SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË NGA HEC-et: "KRYEZI 3", ME FUQI TË INSTALUAR 122.2 kw; "KRYEZI 4", ME FUQI TË INSTALUAR 310.7 kw DHE "KRYEZI 5", ME FUQI TË INSTALUAR 886.5 kw, ME FUQI TOTALE 1320 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; të nenit 4, pika 1, germa "a"; të nenit 5, pika 1, germa "a" dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe të nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "Oberaldi Energjitik" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria "Oberaldi Energjitik" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 442 prot., datë 11.6.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: "Kryezi 3", me fuqi 122.2 kw; "Kryezi 4", me fuqi 310.7 kw dhe "Kryezi 5", me fuqi 886.5 kw.
- Aplikimi i shoqërisë "Oberaldi Energjitik" sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e para-shikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike", si më poshtë:
- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "b", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 2, germa "d" (vërtetim nga Gjykata);
- nenin 9, pika 3 germat "a" (vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave dhe sigurimeve shoqërore) dhe "c" (dokumente që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit);
- nenin 9 pika 4.1.5, germa "b" (leja e përdorimit të ujit), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike", t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Oberald Energjitik" sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet: "Kryezi 3", me fuqi 122.2 kw; "Kryezi 4", me fuqi 310.7 kw dhe "Kryezi 5", me fuqi 886.5 kw, me fuqi totale 1320 kw, për një afat 30-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit

të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti